



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 7.3.2024

Nr: 29

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS PËR EKSPERTË KONTABËL TË LICENSUAR (AUDITUES LIGJOR), PËR AUDITIMIN E SUBJEKTEVE ZGJEDHORE “PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT”, “BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT”, “PARTIA KRISTIAN DEMOKRATE” DHE “PARTIA LËVIZJA PUNËTORE SHQIPTARE”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ë”, e 2, 92/6 dhe 92/7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 15, datë 26.2.2022, “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 14 datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kritereve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”,

V E N D O S:

1. Përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të auditojnë subjektet zgjedhore “Partia Lëvizja e Legalitetit”, “Bashkimi Liberal Demokrat”, “Partia Kristian Demokrate” dhe “Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare” për fondet e përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023, si më poshtë vijon:
 - 1) **Lejla Shahu (Dobi)**
 - Bashkimi Liberal Demokrat.
 - 2) **Meri Lika**
 - Partia Kristian Demokrate.
 - 3) **Eneida Rahmani**
 - Partia Lëvizja e Legalitetit.
 - 4) **Erjon Saraçi**
 - Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare.

Data: 7.3.2024 Nr: 29
Ora: 11:00



“Për plotësimin e vakancës për ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor), për auditimin e subjekteve zgjedhore “Partia Lëvizja e Legalitetit”, “Bashkimi Liberal Demokrat”, “Partia Kristian Demokrate” dhe “Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

2. Ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjorë) do të paraqesin pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve raportet e auditimit për fondet e përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore “Partia Lëvizja e Legalitetit”, “Bashkimi Liberal Demokrat”, “Partia Kristian Demokrate” dhe “Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lidhjes së kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI

